



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK



Komisioni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

Fushë-Arrëz, më 08.10.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e Projektvendimit nr. 32, datë 03.10.2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “ Disa shtesa ne VKB Nr.64, date 23.12.2024, per buxhetin e vitit 2025”.

Analiza ligjore: Ky Projektvendim është hartuar në mbështetje të ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të Njesive te qeverisjes vendore ne Republikën e Shqipërise" i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore ", neni "18"; neni "34", neni "40", neni "41", neni "54" germa "Dh", neni "55" pika 3, neni "64" germa C, Ligjit 68/2017 datë 27/04/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni "4", neni "5" gjerat "a & ç", neni "6" germa "d", neni "7" pika "1", neni "21" pika "3", neni "23", neni "33", neni "39", neni "40", neni "41", Ligjit nr. 9936 date 26.06.2008, "Për Manaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërise" i ndryshuar, Ligjit 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Ligjit 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Ligjit 10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhezimit Vjetor nr. 3, datë 28/02/2024 "për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", Udhezimit nr. 23, datë 30/07/2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetorë afatmesëm të njesive te vetëqeverisjes vendore", Udhezimit nr. 9, date 20/03/2018 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit" i ndryshuar, si dhe Akt-Marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Fushë Arrëz dhe Këshillit të Qarkut Shkodër me nr.3021, datë 29.09.2025 për "Për bashkëpunimin ndërvendor në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike për kryerjen e investimit me objekt Rikonstruksion i rrugës Lagja e Re e qytetit Fushë-Arrëz.

Situata aktuale e funksionit:

Vlera prej 14895000 leke qe do te perdoret e sistemuar ne Grup , Titull Kapitull, artikull si ne table:

Gr.	Tit.	Kap.	Viti	Artikull					Shuma
				600	601	602	230	231	
00	06260	05	2025					14895000	14895000
								14895000	14895000

Situata financiare: Sipas Projektit te paraqitur nga Drejtoria e Finances, **Vlera prej 14895000 leke qe do te perdoret e sistemuar ne Grup , Titull Kapitull, artikull si ne table:**

Gr.	Tit.	Kap.	Viti	Artikull					Shuma
				600	601	602	230	231	
00	06260	05	2025					14895000	14895000
								14895000	14895000

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë vendimin dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Finances ose Drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Vendimi per “ Disa shtesa ne VKB Nr.64, date 23.12.2024 per buxhetin e vitit 2025” impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e lagjes se territorit të bashkise.

Komisioni i Përhershëm për “Ekonomi dhe Financë”, i mbledhur me datën 08/10/2025, shqyrtoi projektvendimin nr. 32, datë 03.10.2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Disa shtesa ne VKB Nr.64, date 23.12.2024, per buxhetin e vitit 2025.”


Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në Relacionin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda 
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Besjana Marku 
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

KËSHILLI BASHKIAK

**KOMISIONI I EKONOMISË FINANCË BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE
PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT STRATEGJIK**

Nr. 3182 prot.

Fushë-Arrëz, më 08.10.2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË FUSHË-ARRËZ

Relacion i Komisionit të Ekonomisë Finance Buxhetit Mbiqyrjes Financiare Planifikimit të Zhvillimit Strategjik mbi Projektvendimin për një shtesë në VKB Nr. 64, datë 23.12.2024 “Për Buxhetin e Vitit 2025”, bazuar në Akt-Marrëveshjen e Këshillit të Qarkut Shkodër me Bashkinë Fushë-Arrëz.

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, u mbledh sot më, 08.10.2025, Komisioni i Ekonomisë Finances Buxhetit dhe Mbiqyrjes Financiare me anetare : Franc Doda (Kryetar i komisionit), Besjana Marku (Sekretare e Komisionit), Zef Cara (Anetar i Komisionit), Valentin Doci (Anetar i Komisionit), Valentina Lleshaj (Anetare e Komisionit). Gjithashtu i pranishëm ishte, Drejtori Zyrës së Finances Z.Dritan Lika, i cili dha shpjegime për projektin e mësipërm.

Drejtori Zyrës së Finances Z.Dritan Lika, shpjegoi se Bashkia Fushë Arrëz ka perfituar nga Këshilli i Qarkut Shkodër një investim në objektin, Rikonstruksion i rrugës Lagje e re, Qytet Fushë Arrëz, Bashkia Fushë Arrëz me vlerë 14 895 000 lekë. Ky investim ka dy vite që nuk është realizuar nga ky institucion për arsye të ndryshme, duke krijuar mjaft problematika në këtë segment rrugor për këtë pjesë të rëndësishme të Qytetit. Me VKQ nr. 20, datë 24.09.2025 Këshilli i Qarkut Shkodër këtë fond ia ka transferuar Bashkisë Fushë-Arrëz në mënyrë që procedura dhe realizimi i këtij investimi të kryhet nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz.

Bashkia Fushë Arrëz ka nënshkruar Akt Marrëveshjen nr. 3021, prot. datë 29.9.2025 me Këshillin e Qarkut, në të cilën janë të parashikuara të gjitha modalitetet për përdorimin e këtij fondi, ku vlen të theksohet fakti se në nenin 4, pika 2 të saj , citohet se fondi do të përdoret vetëm për këtë objekt investimi.

Të gjendur përballë kësaj situate e shohim emergjente ndryshimin e buxhetit për këtë vlerë duke qënë se afatet kohore për këto ndryshime janë në limitet e fundit.

Bashkia do të bëjë çdo përpjekje që të arrijë të kryjë procedurat ligjore për prokurimin dhe realizimin e këtij investimi.

Besjana Marku, anetare e komisionit shprehet dakord me projektin për shtesat në nevojë.

Franc Doda, anëtar i komisionit, njekohesisht anetar i KQ Shkodër, shprehet se është i kenaqur që me në fund behet e mundur që të behet një investim i domosdoshëm në atë segment rrugor tejte të rëndësishëm.

Pa diskutime te metejshe anetaret e komisionit rane dakord me shumice votash duke e derguar projektvendimin per shqyrtim te metejshe dhe miratim ne mbledhjen Plenare te dates 09.10.2025.

Duke kerkuar bashkepunimin tuaj!

PER KOMISIONIN:

Kryetar

Franc DODA



Sekretar

Besjana MARKU



Zef Cera
Valentino Lleshaj

Triun /
Ury